

NJOFIM PËR MOSDISKRIMINIM NËN SEKSIONIN 504

DEKLARATË POLITIKE

Është politikë e Departamentit të Arsimit të Qytetit të Nju Jorkut (DOE), që, në përputhje me Seksionin 504 të Aktit për Rehabilitim të vitit 1973 (Section 504), asnjë person tjetër i kualifikuar me aftësi të kufizuara nuk do të përjashtohet, vetëm për shkak të aftësisë së kufizuar, nga pjesëmarrja, nuk do t'i mohohet përfitimi apo do t'i bëhet diskriminim në ndonjë program apo aktivitet të sponsorizuar nga DOE. Do të respektohen të drejtat për konfidencialitet të personave me aftësi të kufizuara.

Rregullorja e Kancelarit [A-710](#) përshkruan politikat dhe procedurat e DOE, përfshirë procedurat e ankesave, për nxënësit që ndjekin shkollat dhe programet e DOE dhe që janë individë të kualifikuar me aftësi të kufizuara siç përcaktohet në Seksionin 504, dhe që kanë nevojë për akomodime për të marrë pjesë në programet apo aktivitetet e DOE. Kontaktoni Koordinatorin e Seksionit 504 në shkollë, drejtorin, Drejtorin e Shëndetit, ose dërgoni email në 504Questions@schools.nyc.gov, për pyetje apo shqetësime në lidhje me aksesin e një nxënësi të DOE në një program apo aktivitet të DOE, ose në një program jashtëshkollor jo të DOE.

Rregullorja e Kancelarit [A-830](#) përshkruan politikat dhe procedurat e DOE për parandalimin e diskriminimit, përfshirë procedurat e ankesave, për punonjësit, prindërit e nxënësve, nxënësit dhe të tjerët që kanë marrëdhënie pune me DOE, përdorin ambientet e DOE ose ndërveprojnë në çfarëdo forme me DOE.

Drejtoni pyetjet në lidhje me të drejtat ose procedurat për Seksionin 504 **nxënësit** te:

Për Nxënësit dhe Prindërit:

Menaxheri i Programit të Seksionit 504
Zyra e Shëndetit të Shkollave (Office of School Health)
52 Chambers Street
New York, NY 10007
(212) 287-0354
504Questions@schools.nyc.gov

Burim i Jashtëm:

Departamenti i Arsimit i SHBA
Zyra për të Drejtat Civile (Office for Civil Rights)
32 Old Slip, 26th Floor
New York, NY 10005-2500
(646) 428-3900
<http://www.ed.gov/>

Rishikuar. Mars 2025